



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 9.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 8 të Rregullores Nr. 01/2017 për Marrëdhënie Pune, nenit 63 të Rregullores Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm të datës 14 korrik, Zyra Kombëtare e Auditimit shpallë:

KONKURS
për plotësimin e vendit të punës

Pozita:	Drejtor i Përgjithshëm Administrativ
Referenca:	DPA/ZKA/12-07/17
Grada:	K-20
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja:	Me mandat pesë (5) vjeçar
I përgjigjet:	Auditorit të Përgjithshëm
Vendi:	Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Drejtori i Përgjithshëm Administrativ është përgjegjës për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve të Shërbimeve të Përgjithshme Administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Drejtori i Përgjithshëm Administrativ është pjesë e Kabinetit të Auditorit të Përgjithshëm dhe ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të përcaktuara me Ligj dhe me aktet tjera të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Drejtori i Përgjithshëm Administrativ është përgjegjës për:

1. Mbështetjen administrative dhe menaxhimin e Shërbimeve të Përgjithshme Administrative të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke përfshirë edhe çështjet financiare, logjistike, teknologjisë informative dhe prokurimit.
2. Përgatitjen e planeve të punës sipas Planit Vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tij me qëllim të përmbushjes së mandatit dhe funksionit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
3. Bashkëpunim me udhëheqësit e njësive tjera organizative, duke analizuar dhe vlerësuar proceset e punës brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe në pajtim me Auditorin e Përgjithshëm, vendos për ndryshimet dhe përmirësimet me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë.
4. Me autorizim të Auditorit të Përgjithshëm, përfaqëson Zyrën Kombëtare të Auditimit, në fushat dhe çështjet që ndërlidhen me mandatin dhe funksionin e tij.
5. Ofrimin e udhëzimeve dhe këshillave të sakta dhe të paanshme profesionale për Auditorin e Përgjithshëm, në fushat përkatëse.
6. Kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara nga Auditori i Përgjithshëm.

Kërkesat themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale; dhe
- Katër (4) vite përvojë pune menaxheriale.

Kompetencat/shkathtësitë e kërkuara:

- Shkathtësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Procedura e Konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për punonjësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë punonjësit brenda saj.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 01/2017 për Marrëdhënien e Punës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën <http://www.zka-rks.org/> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Musine Kokalari nr. 87 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00. Formularët mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025 dhe 038/606-004, ext:1005.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe në tabelën e shpalljeve.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni për Burime Njerëzore.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda katër (4) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.